**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL ASAMBLY OF MUNICIPALITY SKUPŠTINA OPŠTINE
SKENDERAJ
Nr.
No. 02-052/01-0018878/26
Data.
Data. 22.05.2026

**Komuna Skenderaj**
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

**Zyra për Informim**

| | |
|---|---|
| **Data/Date:** | 21.05.2026 |
| **Nga/Od/From** | Grupi punues për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 01-110/01-0025382/22, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 01-110/01-0031372/25, të datës 01.08.2025. |
| **Për/Za/To:** | Kryetarin i Komunës, z. Sami Lushtaku |
| **CC** | Kryesuesja e Kuvendit Komunal të Skenderajt, znj. Adelina Spahiu |
| **Tema/Subjekat/Subject** | Raporti për ecurinë e hartimit të Draft – Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 01-110/01-0025382/22, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 01-110/01-0031372/25, të datës 01.08.2025. |

Duke u bazuar në nenin 22 dhe nenin 30, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, hartohet ky raport:

Me vendimin nr. 02-020/01-0011611/26, të datës 31.03.2026, Kryetari i Komunës, z. Sami Lushtaku ka themeluar Grupin Punues për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 01-110/01-0025382/22, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 01-110/01-0031372/25, të datës 01.08.2025.

Grupi Punues është themeluar në këtë përbërje:
Albinot Mehmeti, kryesues; Antigona Maliqi, anëtare; Ilmi Kabashi, anëtar; Kreshnik Smakiqi, anëtar; Ramadan Aruqi, anëtar.

**Takimet**

Me 02.04.2026, është mbajtur takimi i parë i grupit punues i udhëhequr nga kryesuesi i grupit, Albinot Mehmeti dhe në pjesëmarrje të të gjithë anëtarëve tjerë. U prezantua Draft – Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 01-110/01-0025382/22, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 01-110/01-0031372/25, të datës 01.08.2025.

Në këtë takim anëtarët kanë diskutuar për rëndësinë e ndryshimit dhe plotësimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 01-110/01-0025382/22, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 01-110/01-0031372/25, të datës 01.08.2025.

Grupi Punues u dakordua që ky draft - rregullore të dalë në konsultim publik nga data 08.04.2026 deri me datë 23.04.2026, kurse diskutimi publik të mbahet me datë 17.04.2026, në sallën e Kuvendit Komunal nga ora 10:30.

## KONSULTIMI PUBLIK

Konsultimi publik u hap më 08.04.2026 me dokumentin i cili u publikua në platforma të ndryshme si dhe duke njoftuar publikun për procesin e konsultimit publik për këtë Draft – Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 01-110/01-0025382/22, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 01-110/01-0031372/25, të datës 01.08.2025 dhe mundësinë e tyre për të dhënë komente.

Publikimi në web faqen zyrtare të Komunës dhe Platformën e Konsultimeve Publike.

Draft – Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 01-110/01-0025382/22, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 01-110/01-0031372/25, të datës 01.08.2025 u publikua në këtë link në faqen zyrtare:

https://skenderaj.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/04/2219_260424112733_001.pdf

**https://skenderaj.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/04/Njoftim.pdf**

**https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=43014**

**KONSULTIMI PUBLIK ME QYTETARË**

Më datë: 17.04.2026 është mbajtur diskutimi publik në sallën e Kuvendit Komunal. Të pranishëm kanë qenë Nënkryetari Komunës, përfaqësues të kompanive te transportit të udhëtareve dhe qytetarë të ndryshëm. Dëshmi janë procesverbali dhe listat e nënshkrimeve.

**Në web faqe:**

https://skenderaj.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/04/Njoftim.pdf

**Në Platformën e Konsultimeve Publike :**

**https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=43014**

**Në Facebook :**

**https://www.facebook.com/share/p/1KWZ7rfaQV/**

Diskutimi publik filloi në orën 10:30, në sallën e Kuvendit Komunal Skenderaj.

Diskutimin publik e shpalli të hapur Albinot Mehmeti, kryesues grupit punues për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 01-110/01-0025382/22, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 01-110/01-0031372/25, të datës 01.08.2025.

**Albinot Mehmeti:**

I nderuar Nënkryetar, të nderuar të pranishëm, qytetarë, ju njoftoj se Kryetari i Komunës e ka formuar Grupin Punues për plotësim-ndryshimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 01-110/01-0025382/22, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 01-110/01-0031372/25, të datës 01.08.2025. Me datë 08.04.2026 kemi publikuar njoftimin publik në ueb-faqen e Komunës për realizimin e konsultimit publik, Po ashtu e kemi publikuar draft-rregulloren për plotësim-ndryshimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 01-110/01-0025382/22, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 01-110/01-0031372/25, të datës 01.08.2025. Plotësim-ndryshimi parasheh ndryshimin e nenit 11, paragrafët 6, 7, 8 dhe 9 të Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 01-110/01-0025382/22, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 01-110/01-0031372/25, të datës 01.08.2025. Nëse dikush ka ndonjë vërejtje apo sugjerim, mund të na kontaktojë edhe në email-at Albinot.Mehmeti@rks-gov.net dhe Besiana.thaci@rks-gov.net , por propozimet mund t'i jepni edhe sot në këtë diskutim publik.

Tani fjalën e ka edhe Nënkryetari.

**Fadil Nura:**

Faleminderit, kryetar i komisionit. Atëherë, më lejoni që t'ju uroj mirëseardhje qytetarëve dhe mirëseardhje të veçantë përfaqësuesve të kompanive transportuese. Mirë se keni ardhur. Lidhur me procedurën e rregullt ligjore për plotësim-ndryshimin e Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Gjoba, e cila adreson çështjen e taksave të stacionit tashmë të funksionalizuar, kemi sigurisht edhe taksa të tjera që janë bazë e rregullores, por për të cilat nuk janë bërë propozime nga drejtoritë përkatëse, p.sh. taksat e lokaleve të ndryshme. Ndërsa sot e kemi diskutimin për tarifat e stacionit të autobusëve. Ne po e ndjekim procedurën e rregullt për plotësim-ndryshimin, ashtu siç e parasheh ligji. Propozimet që do t'i marrim nga qytetarët do të merren për bazë dhe të gjitha këto do t'i adresojmë në Kuvendin e Komunës. Pastaj, Asambleja, me shumicë votash, vendos për tarifat të cilat aplikohen nga data e hyrjes në fuqi të plotësim-ndryshimit të Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Gjoba. Unë kam mbajtur një takim, shkurtimisht, me përfaqësuesit e kompanive transportuese. Qëllimi është që të mos i ngarkojmë. Do t'i marrim edhe opinionet e qytetarëve dhe bashkërisht të vendosim një tarifë e cila është e pranueshme, në kuptimin e interesit të Komunës, interesit të kompanive, por edhe në interes të qytetarëve. Para së gjithash, ky është qëllimi ynë i përbashkët: të mos vendosim tarifa pa konsultim publik, si me kompanitë ashtu edhe me qytetarët. Pa humbur kohë, i kemi anëtarët e komisionit dhe po e hap debatin. Secili që ka arsyeshmëri në kërkesat apo propozimet e veta, çfarëdo që ka, ne i marrim për bazë si komision, në mënyrë që procedura të procedohet në seancën e këtij muaji që vjen. Pastaj, asamblistët, përkatësisht Kuvendi, është akti final që do të votojë. Sigurisht, e kemi edhe Komitetin për Politik dhe Financa, i cili jep rekomandimet e tij, po ashtu edhe asamblistët, të cilët janë të zgjedhurit e popullit. Por e gjithë kjo ka për qëllim që transportuesit, përkatësisht ofruesit e shërbimeve, të pajtohen. Atëherë mund te fillojm me propozimet apo kërkesat për këtë diskutim publik.

| Kërkesat / Sugjerimet / Komentet | Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit te komenteve është i detyrueshëm) |
|---|---|
| **Isak Shala:** Faleminderit te gjithëve për përkrahje por na kemi biseduar me kryetarin dhe kemi marr çmimorën e Mitrovicës dhe Drenasit ku Mitrovica e ka 2 euro Mitrovicë - Prishtinë në qofte se bazoheni këtu po ashtu dhe Drenasi e ka 2 euro Drenas – Prishtinë edhe tjetra pengese është kombit ilegal. | **Albinot Mehmeti:** Ne, si Grup Punues, kemi bërë hulumtime për tarifat të cilat aplikohen në komunat e tjera. Për shembull, kemi vizituar Komunën e Mitrovicës, ku tarifa në relacionin Mitrovicë – Prishtinë ishte 3 euro. Po ashtu, na njoftuan se janë në pritje të ndërrimit të rampës hyrëse, duke kaluar në rampa digjitale, dhe se do ta rishikojnë çmimoren ekzistuese.<br><br>**Fadil Nura :** Nëse me lejohet pak me u ndërlidh me çështjen e kombit ilegal është një problematikë qe jemi duke e vazhduar me ritëm pa u tërhequr si pas Drejtorisë së Inspektoratit janë duke vazhduar me i ndalë dhe kemi arritur më i ndalë por ka punë ende dhe e kemi obligim. |
| **Zeqir Syla:** A ka mundësi ketë rregullore tarifat ti shpjegosh ? | **Albinot Mehmeti :** Tarifat ekzistuese deri më tani janë këto, ndërsa pas pranimit të propozimeve nga ana juaj dhe qytetareve bashkarishtë do të vendosim tarifat e reja.<br>**11.6 Autobusët e relacionit urban:**<br>*Autobusët Mbi 28 ulëse nga 2.5 Euro në<br>* Autobusët Deri 28 ulëse nga 2 Euro në<br>* Autobusët Deri 18 ulëse nga 1.5 euro në<br><br>11.7 **Autobusët e relacionit ndër-urban dhe periferi:**<br>*Autobusët Mbi 28 ulëse nga 2 Euro në<br>* Autobusët Deri 28 ulëse nga 1.5 Euro në<br>* Autobusët Deri 18 ulëse nga 1 Euro në |

| | |
|---|---|
| | **11.8** Vetura /Automjetet deri në 3.5 tonë nga 1 Euro<br><br>**11.9** Vetura /Automjetet mbi në 3.5 tonë nga 2 Euro |
| **Faton Veliu:** Për kombi ilegal një rendësi më të veçantë të kombit ilegal si pikë kryesore e kanë mëngjesin dhe mbrëmjen nga ora 5:30 dhe mbrëmje. | **Fadil Nura :** Të gjitha informacionet i kemi vetëm na duhet pak më shumë kohë sepse ligjërisht nuk kane të drejtë dhe më ketë pjesë do të merremi ne. |
| **Zeqir Syla :** Për ne qe i kemi linjat në fshatra po e shohë si çmim të lartë rritjen e këtij çmimi 2.50 euro i cili çmim është i pa përballueshëm. | **Ilmi Kabashi:** Në bazë të numrit të udhëtarëve bëhet kategorizimi i qarkullimit të autobusëve, pasi që ekzistojnë dallime në numrin e udhëtareve. Në rastet kur numri i udhëtarëve është më i vogël, qarkullimi realizohet me autobusë me kapacitet më të vogël, me qëllim që edhe tarifa përkatëse të jetë më e ulët. |
| **Rifat Hoxha:** Ne jemi të kënaqur me kushtet që na i ofron stacioni i ri dhe, po ashtu, pajtohemi me propozimin e cekur në çmimoren e rregullores. | **Fadil Nura :** Si dhe ju njoftoj se, për tarifat e parkingut pas orarit të punës së linjave të transportit, nuk do t'ju vendosen tarifa të tjera. |

## Propozimet pas Diskutimit Publik të mbajtur me datën 17.04.2026.

**Operatori ekonomik (përfaqësues z.Rrustem Dobra),** përmes takimit me Grupin Punues, ka dhënë propozime për plotësim-ndryshimin e rregullores.

**Operatori ekonomik (përfaqësues z.Rrustem Dobra):** Propozon që në këtë rregullore të largohet kategorizimi sipas numrit të ulëseve, pasi që menaxhimi i tij është shumë më i vështirë, ndërsa tarifat të përcaktohen në bazë të relacioneve. Gjithashtu, propozon që relaconi Skenderaj – Prishtinë të ketë çmim prej 3.50 euro, si dhe të zvogëlohen çmimet e relacioneve urbane dhe urban-periferik në 2 euro.

- Komentet Janë dhënë gjithsej 2 komente dhe 2 komentet janë pjesë e Draft – Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 01-110/01-0025382/22, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 01-110/01-0031372/25, të datës 01.08.2025.

| Tema | Zyra | Pjesëmarrës | Vendi<br>Data | Komentet | 1. Njoftimi<br>2. Draft -Rregullorja<br>3. Mbajtja e Diskutimit Publik |
|---|---|---|---|---|---|
| Draft – Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 01-110/01-0025382/22, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 01-110/01-0031372/25, të datës 01.08.2025. | Zyra për Informim<br>Zyra e Kuvendit | F M T<br>8 16 18 | Salla e Kuvendit<br>17.04.2026 | 2 komente, 2 komentet janë marrë për bazë. | 1. **https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=43014**<br><br>2. https://skenderaj.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/04/2219_260424112733_001.pdf<br><br>3.**https://www.facebook.com/share/p/1KWZ7rfaQV/** |

Ashtu siç është bërë edhe njoftimi publik për qytetarët, të njëjtit kanë pasur mundësi që komentet, vërejtjet apo sugjerimet e ndryshme t`i japin edhe në mënyrë elektronike tek emailat e zyrtarëve. Mirëpo asnjë koment nuk është pranuar në mënyrë elektronike për këtë Draft – Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 01-110/01-0025382/22, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 01-110/01-0031372/25, të datës 01.08.2025.

Grupi punues takimin e fundit e ka mbajtur me datë 23.04.2025 në të cilin janë diskutuar komentet e mbledhura. Kryesuesi i komisionit Albinot Mehmeti ka thënë që të gjitha komentet që janë dhënë gjatë fazës së konsultimit publik janë përfshirë në plan dhe janë pjesë e tij. Meqë faza e konsultimit publik

ka përfunduar, atëherë unë në emër të këtij komisioni një raport mbi procesin e konsultimit publik do të ja dërgoj Kryetarit të Komunës dhe me siguri që ky Draft – Rregullore do të dërgohet shpejt për miratim në Kuvendin e Komunës.

**Bashkangjitur në këtë raport janë edhe këto dokumente:**

Vendimi për caktimin e grupit punues për hartimin e Draft - ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 01-110/01-0025382/22, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 01-110/01-0031372/25, të datës 01.08.2025.

Draft – Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 01-110/01-0025382/22, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 01-110/01-0031372/25, të datës 01.08.2025.

Njoftimin publik për konsultimin publik dhe diskutimin publik.

Listat e nënshkrimeve të pjesëmarrësve në diskutimin publik.

Procesverbal nga Diskutimi Publik për Draft – Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 01-110/01-0025382/22, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 01-110/01-0031372/25, të datës 01.08.2025.

Albinot Mehmeti

Kryesues i Grupit Punues

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL ASAMBLY OF MUNICIPALITY SKUPSTINA OPSTINE
SKENDERAJ

Nr.
No. 02-110/04-0012870/26
Data.
Data. 08.04.2026

Republika e Kosovës
Skenderaj Republika Kosova
Republic of Kosovo

Kuvendi i Komunës
Opstina Skenderaj
Municipality of Assembly

Bazuar në ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Skenderajt Nr. 110-385, neneve 28 dhe 29 të Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna (MAPL), Komuna e Skenderajt lëshon këtë:

**Njoftim publik**

Lidhur me organizimin e konsultimit publik me qytetarë për Draft – Rregulloren për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 01-110/01-0025382/22, të datës 06.06.2022 Për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Nr. 01-110/01-0031372/25, të datës 01.08.2025, në Komunën e Skenderajt.
Ky dokument do të jetë në konsultim publik nga data 08.04.2026 deri me datën 23.04.2026 ndërsa diskutimi publik me qytetarë do të mbahet me datë 17.04.2026, në sallën e Kuvendit Komunal duke filluar nga ora 10:30.
Komentet dhe sugjerimet mund t`i dërgoni deri me datën 23.04.2026 në ora 16:00, në emailat e zyrtarëve: albinot.mehmeti@rks-gov.net dhe besiana.thaci@rks-gov.net .

Për më shumë detaje për Draft-Rregulloren për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 01-110/01-0025382/22, të datës 06.06.2022 Për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Nr. 01-110/01-0031372/25, të datës 01.08.2025, në Komunën e Skenderajt mund t`i vizitoni vegëzat e mëposhtme:

Faqen zyrtare të komunës në internet në rubrikën e konsultimeve publike:
https://skenderaj.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/04/DRAFT-1.pdf

Kryesues i Grupit Punues

Albinot Mehmeti

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

**Komuna Skenderaj**
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

# LISTA E PJESËMARRËSVE

Në diskutimin publik me qytetarë për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 01-110/01-002382/22. të datës 06.06.2022 për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren nr. 01-110/04-0031372/25, të datës 01.08.2025.

**Datë:** E premte, 17 prill 2026,
**Ora:** 10:30,
**Vendi:** Salla e Kuvendit-Skenderaj, Kati IV.

| Emri | Mbiemri | Subjekti | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| | | | |
| ARSIM | FERIJI | [redacted] | [signature] |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

## LISTA E PJESËMARRËSVE

Në diskutimin publik me qytetarë për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 01-110/01-002382/22, të datës 06.06.2022 për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren nr. 01-110/04-0031372/25, të datës 01.08.2025.

**Datë:** E premte, 17 prill 2026,
**Ora:** 10:30.
**Vendi:** Salla e Kuvendit-Skenderaj, Kati IV.

| Emri | Mbiemri | Subjekti | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| Faton | Veliqi | [redacted] | [signature] |
| Zeqir | Sala | | [signature] |
| Gentrit | Idrizi | [redacted] | [signature] |
| Valdrin | Kadriu | [redacted] | [signature] |
| Miradije | Buliqi | | [signature] |
| Besjana | Thaqi | | [signature] |
| Dafina | Shabani | [redacted] | [signature] |
| Venera | Shala | | [signature] |
| Emine | Lushtaku | | [signature] |
| Ali | Nura | | [signature] |
| Armend | Musliu | | [signature] |
| Besnik | Metu | | [signature] |
| Besnik | Smakaj | | [signature] |
| Vlora | Gucati | | [signature] |
| Alban | Musa | | [signature] |
| Miranda | Geci | | [signature] |
| Valerina | Konjuhi | | [signature] |
| Ramadan | Arogi | | [signature] |
| Faton | Osmani | [redacted] | [signature] |
| Besjan | Babaj | [redacted] | [signature] |
| Gentrit | Hasani | [redacted] | [signature] |
| Diedon | Rushiti | | [signature] |
| [illegible] | [illegible] | [illegible] | [signature] |

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

**Komuna Skenderaj**
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

# DRAFT - RREGULLORE NR. 01/2026 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES NR.01-110/01-0025382/22 PËR TAKSA, TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA, E PLOTËSUAR DHE NDRYSHUAR ME RREGULLOREN PËR TAKSA, TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA NR. 01-110/01-0031372/25 - KOMUNA SKENDERAJ

**Skenderaj, Prill 2026**

Në mbështetje të nenit 11 dhe 12, paragrafi 1 dhe 2, shkronja c), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 13 dhe 15 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L -108 Për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Rregullores (MAPL) Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, nenin 14, paragrafi 1 dhe 2 shkronja c) neni 35 paragrafi 1 dhe 2 shkronja c) të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, Kuvendi i Komunës së Skenderajt, në mbledhjen e mbajtur më: 30.04.2026,miraton këtë:

**DRAFT - RREGULLORE NR. 01/2026 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES NR.01-110/01-0025382/22 PËR TAKSA, TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA, E PLOTËSUAR DHE NDRYSHUAR ME RREGULLOREN PËR TAKSA, TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA NR. 01-110/01-0031372/25.**

**Neni 1**
**Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Rregullore është plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores Nr. 01-110/01-0025382/22, të datës 06.06.2022 Për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Nr. 01-110/01-0031372/25, të datës 01.08.2025, të Komunës së Skenderajt.

**Neni 2**

**1. Në nenin 11 ndryshohen dhe plotësohen paragrafët 11.5, 11.6 dhe 11.7, të cilët formulohen si në vijim:**

Neni 11

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE

**11.5 Tarifat në Stacionin e Autobusëve:**

Çmimet për secilën hyrje në Stacionin e Autobusëve përcaktohen në bazë të relacioneve të autobusëve.

**11.6 Autobusët e relacionit ndër-urban:**

- Autobusët e relacionit Skenderaj – Prishtinë **3.5 €;**
- Autobusët e relacionit Skenderaj – Mitrovicë **2.5 €;**
- Autobusët e relacionit Skenderaj – Klinë **2 €;**

- Autobusët e relacionit Skenderaj – Drenas **2 €.**

**11.7 Autobusët e relacionit urban dhe urban-periferik 2 €.**

**2. Në neni 11 hiqen paragrafët 11.8 dhe 11.9.**

**Neni 3**

**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi tridhjetë (30) pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokal dhe brenda shtatë (7) ditësh pas publikimit në web-faqen zyrtare të Komunës së Skenderajt.

**KRYESUESJA E KUVENDIT**

**Znj. Adelina Spahiu – Alija**

______________________

Nr.
No. 02-020101-0011611/26
Data.
Data. 31-03-2026

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

**Zyra e Kryetarit** /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 shkronja a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385 të datës 03.12.2008, ndërlidhur me nenin 2, 3, 4 dhe 5 të Rregullores (MAPL) Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës dhe Udhëzimin Administrativ MAPL Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M**
**(Mbi formimin e grupit punues)**

I. **Themelohet** grupi punues për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr.01-110/01-0025382/22 për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba në Komunën e Skenderajt, në këtë përbërje:

1. **Albinot Mehmeti**, kryesues;
2. **Antigona Maliqi**, anëtare;
3. **Ilmi Kabashi**, anëtar;
4. **Kreshnik Smakiqi**, anëtar;
5. **Ramadan Aruqi**, anëtar.

II. **Detyrë e Grupit Punues** është hartimi i Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba në Komunën e Skenderajt, mbajtja e konsultimit publik dhe raportimi me rastin e miratimit në Kuvendin Komunal.

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Vendimi i dërgohet:**
- Arkivit
- Anëtarëve të Grupit Punues

Kryetari i Komunës

Sami Lushtaku